

L I G J
Nr. 8949, datë 3.10.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8437, DATË 28.12.1998 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 8507, DATË 7.7.1999, NR. 8595, DATË 6.4.2000, NR. 8716, DATË 15.12.2000 DHE NR. 8848, DATË 19.12.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 3, në paragrafin e parë pas shkronjës “F” të ligjit nr. 8437, datë 28.12.1998 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 8507, datë 7.7.1999, nr. 8595, datë 6.4.2000, nr. 8716, datë 15.12.2000 dhe nr. 8848, datë 19.12.2001, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Përfshihen nga akciza kodet 27.10.0081, 27.10.0083 dhe 27.10.0085 të “Nomenklaturës së mallrave dhe tarifave doganore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3512, datë 21.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu